



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Emri i Dorëzuesit Numëro/Prodate Received/Delivery	30.11.2018	3	vit god year
Organ/Njësia Organ./Jednitsa Org./Unit	Nr. Prot: Br. Prot: Prot. No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEKRETHET	729/2018		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 311 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Primijsno/Prodato Received/Delivery		30.11.2018		vid god year
Organ./Klësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMShCK	7291/2018		1172	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

MINISTRINË E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR VITIN
2017

Prishtinë, 2018

1

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Mbikëqyrjes.....	3
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.....	5
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	6
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	7
Procedurat Disiplinore.....	7
Procedurat e Ankesave.....	7
Procedurat e Vlerësimit.....	8
Procedurat e Pushimeve.....	8
Procedurat e Transferimit.....	9
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	9
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	9
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	10
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	10
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	10
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	10
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	11
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	11

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË MINISTRINË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 18.04.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Rregulloren Nr. 37/2013 për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Vendimin me Nr. 967/2017 i datës 17.11.2017 për themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimin me Nr. 968/2017 i datës 17.11.2017 për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Vendimin me Nr. 853/2017 të datës 06.10.2017 për caktimin e Ushtruesit të Detyrës për pozitën "Menaxher i Personelit";
- Vendimin me Nr. 264/2014 të datës 11.03.2014 për caktimin e Ushtruesit të Detyrës për pozitën "Shef i Divizionit për Këshilla Teknike";
- Dosjen e nëpunësit civil për pozitën "Zyrtar i Lartë për rregullim të tokës";
- Dosjen e nëpunësit civil për pozitën Zyrtar i Lartë për Komunitete dhe te drejta";
- Dosjen e nëpunësit civil për pozitën "Zyrtare i lartë për analiza sektoriale";
- Vendimin me nr.ZSP-1148/2015 të datës 17.12.2015 për transferim të përkohshëm;
- Vendimin me nr ZSP-94/2017 të datës 09.02.2017 për pezullim parandalues nga marrëdhënia e punës ;
- Vendimin me Nr.ZSP-32/2017i datës 01.02.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
- Vendimin me Nr.ZSP-411/2017 i datës 19.05.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit
- Vendimin me Nr.ZSP4-12/2017 i datës 19.05.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit
- Vendimin me Nr.ZSP-31/2017 i datës 01.02.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit
- Vendimin me nr.ZSP-116/2017 për kompensimin e një page mujore të njëhershme në vlerë të pagës së fundit
- Vendimin me Nr. ZSP-500/2017 të datës 09.06.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Kërkesa për dorëheqje e datës 28.04.2017
- Marrëveshje për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil e datës 14.08.2017;
- Marrëveshje për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil e datës 17.08.2017
- Marrëveshje për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil e datës 14.08.2017
- Marrëveshje për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil e datës 17.10.2017, kërkesa për transfer e datës 21.06.2017
- Vendimin me Nr.ZSP.1204/2017 i datës 10.01.2017 për pushim të lehonisë dhe flete lëshimi nga QKUK të datës 25.12.2017
- Vendimin me Nr.ZSP.853/2017 i datës 06.10.2017 për pushim të lehonisë dhe flete lëshimi nga Klinika Amerikane të datës 15.09.2017

- Formulari i planit individual të personelit (FPIP) i datës 17.11.2016
- Formulari i planit të trajnimeve i datës 21.03.2017;
- Dosja e procedurës së rekrutimit për pozitën “Zyrtar i lartë për Verëtar”.
- Lista e pagave të muajit dhjetor 2017.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës monitoruese që e ka zhvilluar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural më datë 18.04.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren (QRK) Nr. 37/2013 për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe është përfunduar klasifikimi i vendeve të punës. Në këtë institucion janë të punësuar 149 nëpunës civil, ndërsa pozita të lira janë 9.

Gjatë vizitës, Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civilë ndërsa si kopje janë marrë tri (3) dosje, si në vijim: atë për pozitën “Zyrtar i Lartë për analiza sektoriale”, “Zyrtar i lartë për rregullim të tokës” dhe “Zyrtar për të drejtat e komuniteteve” dhe në bazë të vlerësimit të gjitha dosjet personale ishin të kompletuara në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të nenit 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Ushtruesit e detyrës: Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2017 ka pasur tri (3) pozita me Ushtrues të Detyrës (Udhëheqës i Divizionit për Analiza Ekonomike, Udhëheqës i Divizionit për Këshilla Teknike dhe Menaxher i Personelit). Kolegji për ushtrues detyre për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Analiza Ekonomike” dhe “Udhëheqës i Divizionit për Këshilla Teknike” dhe, ka konstatuar se këto pozita me ushtrues detyre kanë qenë për një periudhë më të gjatë se tre muaj por janë rekrutuar dhe miratuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës më Vendimin me Nr. 215/2017 të datës 15.11.2017 respektivisht 17/2018 të datës 31.01.2018, Kolegji gjatë shqyrtimit të dosjes ka konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me numër Ref. ZSP.714/17 të datës 15.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën “Menaxher i Personelit”, vendimit për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Analiza Ekonomike”, “Udhëheqës i Divizionit për Këshilla Teknike”, konstaton se këto pozita me ushtrues të detyres kanë qenë të angazhuar për një periudhë kohore më shumë se tre (3) muaj.

Me këto veprime, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për sa i përket afatit kohor të caktimit të ushtruesit të detyres.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljeve dhe që me rastin e caktimit të ushtruesve të detyrës të respektohen të gjitha afatet ligjore lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka konstatuar se ka përgatitur planin e personelit dhe gjatë vitit 2017 ka zhvilluar tetë (8) procedura të rekrutimit.

Sipas deklaratimit të personit përgjegjës gjatë monitorimit, është theksuar se në këtë institucion nuk ka pasur asnjë kontratë për marrëveshje për shërbime të veçanta. Gjatë shqyrtimit të dosjeve për pozitën “Zyrtar i Lartë për Verëtar”, ka konstatuar që kjo pozitë në bazë të njoftimit me numër Ref.11.1.07/18 të datës 05.01.2018 është anuluar pasi që nuk është arritur numri i pikëve të duhura nga ana e kandidatëve për vazhdimin e intervistës me gojë sepse vetëm dy kandidatë kanë kaluar testin me shkrim. Kolegji ka vlerësuar që për këtë procedurë kanë konkurruar shtatë (7) kandidatë, në listën e shkurtër janë përfshirë pesë (5) kandidatë të cilët kanë hyrë në testim me shkrim dhe prej tyre vetëm dy kandidatë kanë kaluar testin me shkrim dhe mbi këtë bazë është anuluar konkursi. Andaj, me këtë rast, Kolegji konstaton që në bazë të nenit 32 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit thuhet: **“...Testimi me gojë mbahet vetëm kandidatët, të cilët kanë kaluar testimin me shkrim”** në këtë kuptim testimi me gojë mbahet vetëm për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim dhe nuk ka asnjë dispozitë ligjore ku specifikohet sa është numri i kandidatëve që duhet kalojnë testin me shkrim për tu mbajtur testi me gojë, prandaj Këshilli vlerëson se në momentin kur në testin me shkrim marrin pjesë tre kandidatë të përgjegjshëm, intervista me gojë duhet të zhvillohet me kandidatin/kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim dhe kandidati me më shumë poena (mbi 60%) duhet të rekomandohet për emërim sepse konkurimi në mes të kandidatëve fillon me testimin me shkrim dhe nuk është e obliguar që pastaj edhe në intervistim me gojë me qenë tre kandidatë të përgjegjshëm.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që në rastet e tilla nuk mund të anulohet procedura e rekrutimit me arsyetimin se nuk kanë qenë tre kandidatë në intervistim me gojë, por duhet vazhduar me procedurat e rekrutimit (testin me gojë) sipas nenit 32 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

E GJETURA 2: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, është njoftuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2017 nuk ka dëshmi se sa është numri i angazhimit të marrëveshjeve për shërbime të veçanta, ndërsa Kolegji më datë 19.04.2018 nëpërmjet e-mailit zyrtar kemi kërkuar informata zyrtare/prova nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që të na njoftoni si në vijim:

1. **“Sa kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta janë lidhur në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2017?”**
2. **A është zhvilluar ndonjë procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit lidhur me lidhjen e këtyre kontratave?**

3. A ka tejkalim të afateve të angazhimit të këtyre kontratave dhe sa prej tyre janë lidhur për pozita të Shërbimit Civil, duke kërkuar që të dërgohen të gjitha kontratat për marrëveshje për shërbime të veçanta brenda afatit prej 3 ditësh", ndërsa më datë 19.04.2018 kemi pranuar e-mailin se Ministria e Bujqsisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me të cilin jemi njoftuar që në vitin 2017 nuk ka angazhuar asnjë të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta, rrjedhimisht nuk ka zhvilluar procedurë. Ndërsa, Kolegji gjatë shqyrtimit të Raportit të Auditimit për këtë ministri është konstatuar si: **"MBPZHR për vitin 2017 kishte të angazhuar 38 punonjës me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, pa procedurë të rekrutimit"** (shih, Çështja 7 – Procedurat e rekrutimit me MSHV, faqe 16, Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural), në këtë kuptim, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, respektivisht Sekretari i Përgjithshëm nuk ka bashkëpunuar me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vepruar në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Po ashtu, duke ju referuar Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2017, në të cilin thuhet **"MBPZHR për vitin 2017 kishte të angazhuar 38 punonjës me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, pa procedurë të rekrutimit"**, mund të konstatojmë që Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me rastin e lidhjes së këtyre marrëveshjeve/kontratave nuk ka zhvilluar asnjë procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që ti eliminoj shkeljet dhe me rastin e lidhjes së kontratave me marrëveshjeve për shërbime të veçanta, të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil pasi që duhet zhvilluar një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit dhe të bashkëpunojë me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bazë të Vendimit me Nr. 04/2 të datës 17.11.2017, ka të themeluar Komisionin Disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar që është në pajtim me nenin 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në bazë të vlerësimeve në këtë institucion nuk është iniciuar asnjë procedurë disiplinore.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bazë të Vendimit me Nr. 05/5 2017 të datës 17.11.2017 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili është i themeluar me tre (3) anëtar, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në këtë Komision është parashtruar një

ankesë për të cilën ka vendosur komisioni ndërsa ky vendim i komisionit është shfuqizuar me Vendimin A/02/145/2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, respektivisht eprorët e drejtëpërdrejtë të nëpunësve civilë nuk kanë kryer vlerësimin e rezultateve në punës për 15 nëpunës civilë, edhe pse Zyra e Personelit e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural më datë 20.11.2017 ka përcjell shkresë për drejtorët e departamenteve dhe udhëheqësit e drejtëpërdrejtë të nëpunësve civilë që vlerësimi i rezultateve të punës duhet të bëhet brenda afatit të përcaktuar ligjor. Në vitin 2017, për një (1) nëpunës civil është bërë vlerësimi i periudhës provuese dhe janë respektuar procedurat e përcaktuara ligjore. Lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1 : Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve, ka konstatuar se 15 nëpunës civilë nuk janë vlerësuar nga mbikëqyrësit e drejtëpërdrejtë edhe pse Zyra e Personelit më datë 20.11.2017 ka përcjell shkresë për drejtorët e departamenteve dhe udhëheqësit e drejtëpërdrejtë të nëpunësve civilë që vlerësimi i rezultateve të punës duhet të bëhet brenda afatit të përcaktuar ligjor. Në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve në punë është shkelje e detyrave të punës pasi që për të gjithë nëpunësit civilë duhet të bëhet vlerësimi i rezultateve në punë dhe me rastin e mos vlerësimit të nëpunësve civilë, mbikëqyrësit e drejtëpërdrejtë të këtyre nëpunësve kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e nenit 3 paragrafit 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që ti ndërmarr të gjitha veprimet që sigurojnë që secili nëpunës civil duhet të ketë vlerësimin e rezultateve në punë në fund të vitit ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

Po ashtu, rekomandohet Sekretari i Përgjithshëm që të ndërmarr masa disiplinore ndaj udhëheqësve të drejtëpërdrejtë të nëpunësve civilë të cilët nuk e kanë kryer vlerësimin e rezultateve në punë ndaj vartësve të tyre për periudhën vjetore të vlerësimit për vitin 2017.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural evidencën e pushimeve të nëpunësve civilë e mban në kopje fizike dhe elektronike, dy (2) nëpunës civilë kanë realizuar pushimin e lehonisë, 39 nëpunës kanë realizuar pushimin mjekësor ndërsa nuk ka asnjë nëpunës civil që ka marrë pushim pa pagesë. Në bazë të vlerësimeve për të gjitha pushimet mjekësore, vjetore dhe të lehonisë janë respektuar dispozitat ligjore.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë vitit 2017 ka pasur tri (3) transferime të përhershme të cilat kanë qenë dy (2) të brendshme dhe një (1) të jashtme, të cilët janë lidhur me marrëveshje sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural prej 149 nëpunësve civil, 135 janë të punësuar shqiptar, 11 serb dhe 3 boshnjak

Ndërsa, sa i përket përfaqësimit gjinore, MBPZHR prej 149 nëpunësve civilë sa i ka të punësuar, 58 i ka të gjinisë femra dhe 91 janë të gjinisë mashkullore, ndërsa një (1) nëpunës civil është i punësuar nga personat me aftësi të kufizuara. Lidhur me këtë fushë kemi konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 149 nëpunësve civilë të punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 58 prej të punësuarve janë femra ndërsa 91 janë meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 149 nëpunësve civilë të punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, vetëm një (1) nëpunës është i punësuar nga personat me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, pasi që për çdo 50 të punësuar një duhet me qenë person me nevojë të veçanta.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural një (1) nëpunës civil të pezulluar në këtë institucion, ndërkaq nuk ka pasur nëpunës civil me pezullim të dakorduar, e po ashtu nuk ka pasur nëpunës civil që kanë marrë pushim pa pagesë. Në bazë të vlerësimit të dosjeve një (1) nëpunës civil ka qenë me pezullim parandalues, mirëpo është kthyer në vendin e tij të punës pasi që nuk është vërtetuar aktakuza nga organi i hetuesisë dhe është shpallur i pafajshëm me vendim të organit gjyqësor. Kolegji po ashtu ka konstatuar një (1) nëpunës civil që i është ndërprerë marrëdhënia e punës, një (1) nëpunësi civil që i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të dorëheqjes lidhur me këtë rast ka pasur kërkesë nga nëpunësi civil dhe është nxjerrë vendimi, katër (4) nëpunës civil që iu ka përfunduar marrëdhënia e punës me vendim si dhe katër (4) nëpunës civil e kanë arritur moshën e pensionimit me vendim dhe i është bërë pagesa e një page të njëhershme.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural se nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mban pozitë të shërbimit civil dhe ndonjë post tjetër publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural se ka pasur një (1) nëpunës civil ndaj të cilit është filluar procedura penale, mirëpo me vendim të organit gjyqësor është shpallur i pafajshëm dhe është rikthyer në vendin e tij të punës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural respektivisht zyra e personelit, ka përgatitur planin e trajnimeve në të cilin përfshihen edhe trajnimet, po ashtu është përgatitur edhe Formulari 3 individual të trajnimeve, por dhe të cilat trajnime janë marrë parasysh nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, vijimin në punë e mban në formë elektronike.

Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet, ndërsa shtesa në pagë gëzojnë IT .

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2017 ka pranuar vetëm një (1) vendim të Këshillit dhe për të cilin ka pasur obligim të zbatoj ndërsa në bazë të provave të lëndës është zbatuar.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2017 është monitoruar për vitin 2016 dhe janë dhënë dhjetë (10) rekomandime ku gjashtë (6) prej tyre janë adresuar ndërsa nuk janë adresuar katër (4).

15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar gjashtë (6) të gjetura dhe ka dhënë gjashtë (6) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Koment i veçantë: Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk kanë dhënë informata, respektivisht i kanë fshehur të dhënat lidhur me personat e punësuar me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

Shkëmb MANAJ

Kryetar i Kolegjit

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

I dërgohet:

- Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
- Arkivit të KPMSHCK